



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
 KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS - TUZILAÇKI SAVET KOSOVA
 SEKRETARIJATI - BURETARIJAT
 ARKIVA - ARHIVA

Pranuar 25 -10- 2022 Prilajeno

| | | |
|---------------------------|----------------------------|---------------------------------------|
| Numri i rander Redni broj | Orë e pranimit Ças prijema | Nenshkrimi i pranimit Potpis primaoca |
| | | 1767 |

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo

Këshilli Prokurorial i Kosovës -Tužilački Savet Kosova – Kosovo Prosecutorial Council

MEKANIZMI I RAPORTIMIT

TË KRYEPROKURORIT TË PROKURORISË SPECIALE

NË KËSHILLIN PROKURORIAL TË KOSOVËS

I. PJESA E PËRGJITHSHME:

| Blerim Isufaj | | Prokuroria Speciale | | Korrik - Shtator 2022 | | Nenshkrimi | | | | | | | | | | | | | |
|--|-----------------------|--|-----------------------------|--|---|--|-------------------|---|---------|-----------------------|---------|------------------|---------|--------------------|---------|--------------------|---------|--------------------|---------|
| Emri, mbiemri Kryeprokurorit | | | | Periudha raportimit | | | | | | | | | | | | | | | |
| Numri i prokurorëve dhe stafit administrativ në prokurori: | | Kryeprokurori: | | 1 | Administratori: | | 1 | | | | | | | | | | | | |
| | | Prokurorë | | 16 | Personel | | 71 | | | | | | | | | | | | |
| | | Totali: | | 17 | Totali: | | 72 | | | | | | | | | | | | |
| A) Numri i kallëzimeve penale të pranuar: 28 (1 rast i rihapur) | | B) Numri i kallëzimeve penale të proceduara 16 | | C) Përqindja e rasteve të proceduara (B%A) 57.14% | | D) Ngarkesa me lëndë 574 raste PPS | | | | | | | | | | | | | |
| Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga prokurori: | Aktakuza të ngritura: | | Hudhje të kallëzimit penal: | | Pushim i hetimeve: | | Mënyrë tjetër: | | | | | | | | | | | | |
| | 3 r - 19 p | | 7 r - 24 p | | 8 r - 19 p (plus në 1 rast ndaj 11 personave është pushuar hetimi vetëm për vepër penale) | | 3 r - 6 p | | | | | | | | | | | | |
| Mënyra e zgjidhjes së lëndëve nga gjykata: | Aktakuza të hudhura | | Aktakuza të refuzuara | | Aktgjykime liruese | | Aktgjykimi dënues | | | | | | | | | | | | |
| | 4 | | | | 6r - 52 persona | | 6r - 15 persona | | | | | | | | | | | | |
| Ankesa kundër aktgjykimit | | | | Ankesa kundër aktvendimit | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të aprovuara | | | | Të refuzuara | | | | | | | | | | | | | | | |
| / | | | | 3 (prej tyre 1 jolëndore) | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të aprovuara | | | | 7 | | | | | | | | | | | | | | | |
| / | | | | 1 | | | | | | | | | | | | | | | |
| Arritshmëria e normës orientuese të prokurorëve, për periudhën kohore të raportimit: | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Arritshmëria e normës së PSRK-së, në përqindje, për periudhën raportuese: | | | | | | 16.67 % | | | | | | | | | | | | | |
| Performanca e prokurorisë në luftimin e Korrupsionit (Paditë Penale 'PP'). Shëno të dhënat në tabelë: | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Raste të pranuar | | Raste të kryera: | | Ngarkesa me raste: | | Hudhje | | Pushim | | Janë ngritur Aktakuza | | Aktakuza hudhura | | Aktakuza refuzuara | | Aktgjykime liruese | | Aktgjykime dënuese | |
| R ¹ | P ² | R | P | R | P | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona |
| 18 | 41 | 9 | 32 | 89 | 397 | 24 | 4 | / | / | 1 | / | / | / | / | / | / | / | / | 2 |
| Performanca e prokurorisë në luftimin e Krimit të organizuar (Paditë Penale 'PP'). Shëno të dhënat në tabelë: | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Raste të pranuar | | Raste të kryera: | | Ngarkesa me raste: | | Hudhje | | Pushim | | Janë ngritur Aktakuza | | Aktakuza hudhura | | Aktakuza refuzuara | | Aktgjykime liruese | | Aktgjykime dënuese | |
| R | P | R | P | R | P | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona |
| 3 | 33 | 4 | 44 | 85 | 474 | / | 25 | 19 | 5 | / | / | / | / | / | / | 48 | 13 | / | / |
| Performanca me rastet e shenjëzuar (top 50). Shëno të dhënat në tabelë: | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Raste të pranuar | | Raste të kryera: | | Ngarkesa me raste: | | Hudhje | | Pushim | | Janë ngritur Aktakuza | | Aktakuza hudhura | | Aktakuza refuzuara | | Aktgjykime liruese | | Aktgjykime dënuese | |
| R | P | R | P | R | P | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona | Persona |
| 2 | 24 | 1 | 6 | 82 | 740 | / | / | 6 | / | / | / | / | / | / | / | 3 | 12 | / | / |
| Performanca e prokurorisë në sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme: Shëno të dhënat në tabelë: | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Kërkesa të aprovuara për dhënie të urdhrave për sekuestrim të përkohshëm | | Kërkesa të aprovuara për konfiskimin e pasurisë dhe mjeteve financiare | | Kërkesa të aprovuara për dhënie të aseteve në shfrytëzim të qeverisë | | Kërkesa të aprovuara për dhënie të aseteve në administrim të AAPSK | | Kërkesa për kompenzimim e palës së dëmtuar nga mjetet e konfiskuara | | | | | | | | | | | |
| 11 | | 2 | | / | | / | | / | | | | | | | | | | | |

II. POLITIKAT DHE PRIORITETET E SISTEMIT PROKURORIAL:

| | |
|---|--|
| 1 | <p>Niveli i organizimit, menaxhimit, administrimit dhe funksionimit të prokurorisë?</p> <p>Komento:</p> <p>Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, në konsultim me organet drejtuese të Sistemit Prokurorial dhe me partnerët ndërkombëtar, përmes strategjisë për riorganizimin dhe Planit të Punës, ka përcaktuar veprimet strategjike të PSRK-së, me qëllim të përmbushjes së mandatit ligjor në mënyrë efektive dhe efikase si dhe në rritjen e besimit të publikut ndaj Prokurorisë Speciale.</p> <p>E gjithë kjo është realizuar duke ju referuar Strategjisë për riorganizimin e PSRK-së, Planit të punës, Politikave të Menaxhmentit si dhe Detyrave dhe përgjegjësi të përgjegjësi të departamentit në PSRK.</p> |
| 2 | <p>Çështjet e avancimit dhe transferimit të prokurorëve?</p> <p>Komento:</p> <p>Në kuadër të PSRK-së, gjatë kësaj periudhe raportuese, nuk ka pasur lëvizje të Prokurorëve.</p> |
| 3 | <p>Çështjet e përgjegjësisë disiplinore të prokurorëve apo stafit mbështetës?</p> <p>Komento:</p> <p>PSRK-ja, gjatë kësaj periudhe raportues nuk ka pasur asnjë rast të ngritjes në procedurë disiplinore të asnjë Prokurori dhe asnjë personeli administrativ në kuadër të saj.</p> |
| 4 | <p>Çështjet e vlerësimit të punës së prokurorëve përfshirë mospajtimet e prokurorëve?</p> <p>Nivelet e vlerësimit të prokurorëve si dhe tejkalimi kuotës 20% të dalluar?</p> <p>Komento:</p> <p>Prokurora Speciale, ka vlerësuar punën e Prokurorëve për periudhën e vitit të kaluar, dhe nuk ka pasur asnjë mos pajtim nga ana e tyre rreth vlerësimit të bërë.</p> <p>Konsideroj se vlerësimi i performancës është një instrument tejet i rëndësishëm në dispozicion të një udhëheqësi dhe një mënyrë e mirë jo vetëm për të përmbushur obligimin ligjor për vlerësim të performancës së prokurorëve dhe rrjedhimisht edhe prokurorisë, por edhe për motivim dhe si mjet për identifikim të aspekteve që duhet të përmirësohen te secili prokuror, gjithmonë parë nga perspektiva e një eprori.</p> <p>I vetëdijshëm që në procesin e vlerësimit të performancës mund ta kem tejkalluar kuotën e përcaktuar në Nenin 13 pika 2 të Rregullores për vlerësimin e performancës, mirëpo kanë qenë disa faktorë që më kanë shtyrë për një veprim të tillë, shto dhe faktin që vetë rregullorja lejon fleksibilitet në tejkallim të kësaj kuote. Megjithatë ndër faktorët kryesorë që kanë ndikuar në vlerësimin e performancës së prokurorëve në këtë formë kanë qenë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ndryshimet strukturore të PSRK; - Performanca e PSRK-së në vit pandemie; - Mospasja e një plani paraprak vjetor me objektiva dhe targete të përcaktuara; - Motivimi i prokurorëve përmes vlerësimit të performancës; - Sistemi i ri i vlerësimit të performancës; |
| 5 | <p>Çështjet e rasteve të ndërlikuara dhe vendimet nga Kryeprokurori për njohjen e këtyre rasteve ?</p> <p>Komento:</p> <p>Prokurorisë Speciale, gjatë periudhës Korrik – Shtator nuk ka asnjë rast / vendime</p> |
| 6 | <p>Ankesat ndaj shqiptimit të sanksionit penal të shqiptuar (<i>Udhëzimi i Kryeprokurorit të Shtetit mbi rolin dhe kontributin e prokurorit të shtetit në matjen e dënimit</i>) ?</p> <p>Komento:</p> <ul style="list-style-type: none"> - 10 Ankesa kundër Aktgjykimit dhe - 9 Ankesa kundër Aktvendimit |
| 7 | <p>Zbatimi i politikave, standardeve dhe udhëzimeve sa i përket trajnimit të prokurorëve dhe personelit?</p> <p>Cilat janë kriteret e përzgjedhjes së prokurorëve mentorë për prokurorët fillestar?</p> <p>Komento:</p> <p>Menaxhmenti i PSRK-së, në vazhdimësi ka zbatuar politikën, standardet dhe udhëzimet e KPK-së dhe ato të vetë-krijuara me qëllim të ngritjes së efikasitetit të punës së Prokurorisë / Roli i PSRK nuk është i përcaktuar në përzgjedhjen e mentorëve.</p> |

| | |
|----|--|
| | Profesionale, duke treguar gjithherë nivel të lartë të profesionalizmit/ nuk kemi asnjë rast të hapur për shkelje të etikës. |
| 9 | <p>Niveli i pavarësisë së prokurorëve që të veprojnë në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të paanshme gjatë kryerjes së funksioneve prokuroriale?</p> <p>Komento:</p> <p>Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale, vlerëson se të gjithë Prokurorët e saj, janë duke vepruar me integritet dhe në mënyrë të pavarur në kryerjen e detyrave të tyre të përditshme prokuroriale, duke treguar profesionalizëm dhe paanësi, në një nivel të kënaqshëm, për të cilin do të angazhohemi në vazhdimësi me qëllim të ngritjes së këtij niveli.</p> |
| 10 | <p>Zbatimi i politikave të KPK dhe ZKPSH, në luftimin e kriminalitetit për veprat penale karakteristike të Mekanizmit Përcjellës Ndërinstitucional ?</p> <p>Komento:</p> <p>Për të zbatuar këto politika dhe përgjegjësitë e prokurorëve dhe prokurorisë, Kryeprokurori i PSRK-së vlerëson se duhet të punohet si ekip për të siguruar që:</p> <ol style="list-style-type: none"> (1) rastet e pranuar në prokurori të hetohen me kohë, të ngritën aktakuzat ose të hedhen poshtë apo të pushohen hetimet; (2) të ngritën aktakuza vetëm kur ekzistojnë prova adekuate që mbështesin akuzat; (3) të përgatiten dokumente gjyqësore që kanë logjikë në aspektin ligjor dhe do të kenë qëndrueshmëri në gjykatë; <p>Në përpjekje për të përmirësuar efikasitetin dhe ekspertizën janë themeluar departamente të specializuara, ku secili do të mbikëqyren nga një Përgjegjës i Departamentit të cilët kanë përgjegjësi për të ndihmuar në përmirësimin e punës në fushat e përcaktuara më lartë nga politikat e menaxhimit.</p> |
| 11 | <p>Niveli i zbatimit të kërkesave nga Komisionet e Përhershme të Këshillit dhe nga vet KPK-ja?</p> <p>Komento:</p> <p>Gjatë kësaj periudhe, nuk është pranuar ndonjë kërkesë nga Komisionet e Përhershme të KPK-se.</p> |
| 12 | <p>Niveli i zbatimit të strategjisë për krime të luftës?</p> <p>Komento:</p> <p>Në lidhje me nivelin e zbatimit të strategjisë për krime të luftës mund të vlerësohet se është bere një pune e mire ku nder te tjerë mund të theksojmë si ne vijim :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Formimi i task forcës së brendshme për evidentimin e të gjitha lëndëve në pune (nga të gjeturat rezultoi që kishte duplikim të lëndëve); - Formimi i task forcës PSRK - Polici ku është bërë harmonizimi i rasteve në mes këtyre dy institucioneve si dhe caktimi i 5 hetuesve për secilin prokurorë të krimeve të luftës ku njëri është koordinator (gjithsejtë 20 hetues); - Ndarja e lëndëve sipas regjioneve dhe përcaktimi i prokurorëve për regjione (kjo mundëson që secili rast i ri që vjen në punë të verifikohet fillimisht nga prokurori përkatës dhe të eliminohet duplikimi) |
| 13 | <p>Performanca e prokurorëve në përdorimin e sistemit SMIL ?</p> <p>Komento:</p> <p>Sa i përket performances së treguar deri me tani në me çështjen e përdorimit te sistemit SMIL nga ana e Prokuroreve të PSRK-së, vlerësojë se jam relativisht i kënaqur, mirëpo në çdo mbledhje të kolegjiutit kjo çështje vazhdon të trajtohet me prioritet nga ana e Kryeprokurorit (në rend dite).</p> |
| 14 | <p>Sfidat apo të arriturat:</p> <p>Komento:</p> <p>Ndër sfidat kyqe për periudhën e ardhshme, vlerësojmë se mund të përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Menaxhimi i proceseve të punës me strukturën e re organizative të PSRK dhe menaxhimi i lëndëve sipas kompetencës së departamenteve; - Angazhimi i vazhdueshëm për ndërlidhjen e sistemeve elektronike (SMIL) ndërmjet tri institucioneve të pavarura: Polici-Prokurori-Gjykatë; - Aplikimi i plotë i proceseve të punës përmes sistemit elektronik SMIL; - Bashkëpunimi me Tribunalin për Krime Luftë në Hagë; - Ushtrimi i veprimtarisë në ndërtesë e cila nuk ka ofruar kushtet e duhura për punë, pasi që ndërtesa është në renovim: |

III. ZBATIMI I OBLIGIMEVE SIPAS PLANIT TË PUNËS TË PROKURORISË SË SHQITË

| | |
|---|--|
| 1 | <p>Objektivi 1: Rritja e efikasitetit në trajtimin e rasteve penale me prioritet.</p> <p>Komento:</p> <p>Për të siguruar një shkallë të lartë të efikasitetit të trajtimit të rasteve, politikat për Kryeprokurori i PSRK-së kanë përcaktuar disa veprime konkrete të cilat duhet të ndërmerren nga prokurorët e rasteve. Sipas këtyre politikave, secili prokuror duhet të përgatis një raport të përmbledhur (pa dhënë informata dhe të dhëna për përmbajtjen e rastit) në të cilin paraqiten informatat për rrjedhën e rasteve në periudhën raportuese. Ky raport do të përmbaj të dhëna të përgjithësuara lidhur me pengesat që paraqiten për përfundimin e rasteve, duke përfshirë statusin e rastit, afatin e hetimit, afatin e parashkrimit, dhe sekuestrimin nëse ka, si dhe do të mundësoj që rastet të cilat kanë prova të mjaftueshme të procedohen pa vonesë, e po ashtu përmes këtij raporti do të synohet që të vë në qendër dhe si prioritet kryesor të aktiviteteve prokuroriale ndjekjen penale dhe hetimin e rasteve, përfshirë edhe trajnimet.</p> <p>Paraprakisht do të bëhet një vlerësimi i efektit dhe përmbushjes së politikave për menaxhimin e PSRK-së si dhe përcaktimit të formatit të raportit tremujor nga ana e Kryeprokurorit dhe përgjegjësve të departamenteve.</p> |
| 2 | <p>Objektivi 2: Fuqizimi i besimit të publikut në punën e Prokurorit të Shtetit.</p> <p>Komento:</p> <p>Njëra ndër objektivat e përcaktuara në Strategjinë për organizimin e PSRK-së, ka të bëjë me Fuqizimin e besimit të publikut në raport me punën dhe aktivitetet e PSRK-së, me qëllim të arritjes së bashkëpunimit dhe komunikimit efektiv, me fokus të veçantë në aktet përkatëse normative të Këshillit Prokurorial dhe Kryeprokurorit të Shtetit.</p> <p>Për më tepër, PSRK, është e përkushtuar që të jetë e koordinuar duke krijuar standard të larta në publikimin e informacioneve të punës së prokurorëve special dhe të PSRK-së në përgjithësi. Në veçanti është punuar dhe do të vazhdojë të avancohet në koordinim të brendshëm dhe me ZKPSH-në, në informimin e opinionit për rastet komplekse dhe të krimeve më të rënda.</p> <p>Po ashtu, PSRK vazhdon të luajë një rol proaktiv në informimin e opinionit për punën dhe aktivitetet e PSRK-së, e gjithë kjo me qëllim të përmirësimit të imazhit dhe perceptimit pozitiv të publikut për sistemin prokurorial.</p> <p>Disa nga prioritetet e kësaj objektive, kanë të bëjnë me:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Takime me qytetarë dhe media – zhvillimi i planit për takime,▪ Publikim të statistikave,▪ Standardizim dhe unifikim të informacionit të brendshëm dhe të jashtëm. |
| 3 | <p>Objektivi 3: Rritja e shkallës së sekuestrimit në funksion të konfiskimit përfundimtar të aseteve të fituara me vepër penale.</p> <p>Komento:</p> <p>Po ashtu, njëra ndër objektivat e përcaktuara në Strategjinë për organizimin e PSRK-së, ka të bëjë me zbatimin efektiv të procedurave të ngrirjes, sekuestrimit dhe konfiskimit të pasurisë, ku me qëllim të arritjes së objektives përkatëse PSRK ka ndërmarr dhe do të ndërmerr në vazhdimësi veprime për arritjen e prioriteteve të theksuara si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none">▪ Forcojë burimet njerëzore dhe mekanizmat ekzistues në zbatim të legjislacionit të fushës,▪ Intensifikojë aktivitetet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtarë,▪ Hartojë procedura standarde të veprimit,▪ Hartoj udhëzues dhe politika për zbatim të legjislacionit,▪ Fuqizojë mekanizmat monitorues dhe të raportimit. |

| | |
|---|---|
| | <p>nderlikushmerin e rasteve ka qene e pa mundshme që të arrihet norma e përcaktuar sipas udhëzimit, PSRK gjatë periudhës tremujore arrishtëmëria e normës së PSRK-së, në përqindje, për periudhën raportuese është 21.11%</p> <p>Ndërsa referuar trendit të punës shpresoj se ne raportimin e ardhshëm kjo përqindje do të rritet dukshëm.</p> |
| 5 | <p>Objektivi 5: Vlerësimi i rrezikut dhe planifikimi i vazhdimisë së punës në pandemi.</p> <p>Komento:</p> <p>PSRK-ja, ka vlerësuar të gjitha rreziqet e mundshme, përfshirë sigurinë dhe menaxhimin me pandeminë COVID19, të cilat kanë qenë ndër sfidat dhe prioritetet kyçe, në hartimin dhe zbatimin e strategjisë për riorganizim dhe Planin e Punës për 2022, ku vlen të përmendet planifikimi i kryerjes së punëve të përditshme përmes numrit të reduktuar të stafit dhe punës në distancë, edhe gjatë kësaj periudhe raportuese. Deri më tani mund të vlerësohet se është rezultat i kënaqshëm në lidhje me menaxhimin e pandemisë, pasi është arritur që puna dhe aktivitetet e PSRK-së të mos ngecin, por të vazhdojnë në zbatim të plotë të të gjitha afateve të kërkuara ligjore.</p> |
| 6 | <p>Objektivi 6: Administrimi efikas, llogaridhënia dhe rritja e profesionalizimit:</p> <p>Komento:</p> <p>PSRK-ja, deri më tani ka arritur të administrojë në mënyrë efikase në të gjitha fazat përfshirë hetimin, ndjekjen dhe marrjen e vendimeve adekuate (ngritja e aktakuzave, pushimi i hetimeve, hedhje e kallëzimeve penale etj.) si dhe përfaqësimi i rasteve para gjykatave, qoftë gjatë shqyrtimit, qoftë përmes parashtrimit të mjeteve juridike në mënyrë efikase dhe efektive, gjithnjë duke aplikuar një varg masash ligjore, institucionale dhe organizative, me qëllim të angazhimit të të gjitha resurseve në funksion të rritjes së performancës së prokurorisë.</p> <p>Theks të veçantë duhet vënë tek bashkëpunimi me institucionet e zbatimit të ligjit për rritjen e cilësisë së kallëzimeve penale dhe hetime efektive, si dhe unifikimit të praktikave të punës dhe zbatimit efektiv të procedurave të ngrirjes, sekustrimit dhe konfiskimit të pasurisë së fituar me vepër penale, krijimin e listave të kontrollit (checklist), rritjen e llogaridhënies, integritetit, kontrollit dhe mbikëqyrjes së përhershme të punës së prokurorëve duke ruajtur pavarësinë e tyre për trajtimin e rasteve por në funksion të cilësisë së punës si dhe veprimeve tjera të përcaktuara në planin e veprimit.</p> |
| 7 | <p>Objektivi 7: Aplikimi më efikas i procedurave alternative në zgjidhjen e rasteve penale.</p> <p>Komento:</p> <p>Nuk aplikohen në rastin e PSRK-së</p> |
| 8 | <p>Objektivi 8: Bashkëpunimi vendor dhe ndërkombëtar i Prokurorit të Shtetit:</p> <p>Komento:</p> <p>PSRK-ja, vazhdon të jetë e angazhuar në mënyrë proaktive në informimin e opinionit për punën dhe aktivitetet e saj. Kjo do të ndikojë në pasqyrimin e drejtë, të saktë dhe në kohë, për punën si dhe do të ketë efekt në përmirësimin e imazhit dhe perceptimit pozitiv të publikut në sistemin prokurorial.</p> <p>Në veçanti do të punohet në koordinim të brendshëm dhe me ZKPSH-në në informimin e opinionit për rastet komplekse dhe të krimeve më të rënda të cilat përbëjnë interes të veçantë për publikun. Gjithashtu ky bashkëpunim do të shtrihet me të gjitha institucionet vendore si dhe mekanizmat ndërkombëtarë me të cilët PSRK synon të ndërtojë një komunikim të përhershëm dhe shumë të ngushtë për të gjitha proceset strategjike të zhvillimit të prokurorisë.</p> <p>Standardizimi i informacionit dhe mënyrës së komunikimit me publikun do të kenë vëmendje të posaçme.</p> |


IV. KËRKESAT SPECIFIKE TË KPK-së (për periudhën e konkrete të shenjzuar të raportimit)

| | |
|---|--|
| 1 | |
| 2 | |
| 3 | |
| 4 | |
| 5 | |
| 6 | |
| 7 | |
| 8 | |

V. ASPEKTE ADMINISTRATIVE:

| Raportimi | Periudha kohore për të cilën raportohet | Shenjzimi |
|-----------|--|-------------------------------------|
| I parë: | Nga 1 janari deri më 31 mars të çdo viti | <input checked="" type="checkbox"/> |

| | |
|---|--|
| Këshilli Prokurorial i Kosovës ka kërkuar nga Kryeprokurori që të dorëzoj raportin: | Kryeprokurori e ka dorëzuar raportin në Këshill (para raportimit): |
| Me datë: 25.10.2022  | Me datë: _____ |



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor

Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës / Kancelarija Specialnog
Tuzilastva Republike Kosovo / Special Prosecution Office of the Republic of
Kosovo

Fletëdërgesë për dorëzim personal

A.nr. 234/2022

Me datë 25.10.2022

Për: zt. Jetish Maloku – Kryesues i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Titulli i dokumentit:

Mekanizmi i raportimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale në Këshillin
Prokurorial të Kosovës e datës 25.10.2022 .

Më: 25.10.2022 në ora 14:29

Marrësi :

Dërguesit: _____